



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 295/1 Prot.

Shkodër, më/4.04.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 26, datë 29.03.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të VKM nr. 68, datë 31.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 13, datë 18.04.2018 "Për zbatim të VKM nr. 54, datë 5.02.2014", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2393 prot., datë 04.04.2023 mbi dokumentacionin e mbledhjes", shqyrtoi *VKB nr. 26, datë 29.03.2023 "Për dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qira me konkurrim publik të sipërfaqes prej 3925 m2 (përaktësisht 3000 m2 dhe 925m2), me afat deri në 10 vjet, pjesë e pasurisë nr. 546/4, ZK 3506, e llojit "Pa frut", në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës".*

Pas trajtimit, Prefekti ju lejon procedim të mëtejshëm, duke zbatuar kriteret (niveli i investimit, punësimit, oferta e detyrimit mujor të qerasë) sipas VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 dhe tarifata e vendosura nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 26 Datë 29.03.2023

Dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qira të sipërfaqes prej 3925 m², me afat deri në 10 vjet, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, në fshatin Stajkë, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Në VKM nr. 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.01.2008, të këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, kapitulli I, pika 2, të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, dhe në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit nr 07, datë 31.01.2023, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. Dhënie e pëlqimit për dhënie me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 3925 m², (përkatesisht 3000 m² dhe 925 m²), pjesë të pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, ndodhur në fshatin Stajkë, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.
Fusha e përdorimit të pronës: Për zhvillim aktiviteti në fushën e blegtorisë, bujqësisë, agropërpunimit sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

Sekretar i KB: Ardian Çelepija

Kryetar K.B : Mark Bisha

Miratuar me 19 vote

Vota pro 19

Vota kundër -

Vota abstenim -

Zbardhur me datë 03.04.2023

